

NOTE INFORMUESE

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të drejtësisë për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të gjyqtarit M.K.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor ndaj gjyqtarit M.K. të Gjykatës së rrethit Korçë më 2.04.2020, bazuar në një kërkesë të depozituar nga ministri i Drejtësisë, pasi gjyqtari më 14.02.2019 vendosi/urdhëroi lirim të dënuarit me burgim të përjetshëm G.Gj, i gjetur fajtor për një vrasje të kryer në vitin 1997. Vendimi për lirim u rrëzua nga Gjykata e Apelit Korçë gjashtë muaj më vonë.

Hetimi i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 140, pika 2, shkronja “a”), dhe të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, (neni 102 pika 2 shkronjat “a” dhe “b”), konkludon se magjistrati ka kryer veprime e mosveprime me dashje, në mënyrë të drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme e të pajustificuar brenda të njëjtit proces. Hetimi disiplinor ka konstatuar mes të tjerash, zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit material dhe procedural penal; referenca kontradiktore; mosrespektim të kriterëve ndalues të lirimit me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje; arsyetim jo në përputhje me provat e administruara në gjykim e as me faktet dhe rrethanat e provuara gjatë procesit gjyqësor. Këto të fundit janë parashtruar dukshëm në mënyrë të shtrembëruar.

- Vetë magjistrati ka injoruar edhe praktikën e ndjekur prej tij, gjatë trajtimit të kërkesave të ngjashme me objekt “Lirim me kusht”, duke sjellë disa pasoja:
- Natyra dhe rrethanat e shkeljes disiplinore të gjyqtarit M.K. kanë prodhuar mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal.
- Pasojat e shkeljes disiplinore kanë sjellë lirim të dënuarit, që përbën rrezik për komunitetin dhe shoqërinë, e në kundërshtim me parashikimet legjislacionit material dhe procedural penal.
- Pasojat e shkeljes disiplinore kanë shkaktuar cënimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë
- Sjellja e papërshtatshme e magjistratit mbart rrezikun e krijimit të një precedenti për t’u ndjekur edhe nga magjistratë të tjerë, duke krijuar terren për sjellje të papërshtatshme dhe në raste të tjera të ngjashme.

Të gjitha veprimet e mosveprimet e ndërmarra e të evidentuara në mënyrë të detajuar në raportin e hetimit, përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”, pasi vlerësohen si akte që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe për rrjedhojë e bëjnë atë të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e tij si magjistrat. Për pasojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit M.K., me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për shkeljet disiplinore të parashikuara nga Kushtetuta e Shqipërisë (neni 140, pika 2, shkronja “a”) dhe Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”) dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.